

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Specialist (Digital Forensic Analyst)	Reparti Ushtarak nr.6601	Tiranë	Pa afat	Po	Po	08.03.2023	22.03.2023

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Specialist (Digital Forensic Analyst), në Sektorin Special të Sigurisë Kibernetike, në Njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak Nr.6601, Shtabi i Përgjithëm i Forcave të Armatosura.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 08.03.2023
8. Data e mbylljes së aplikimit: 22.03.2023
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>
10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

a. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

b. Grada/Titulli: Civil/Specialist (Digital Forensic Analyst)

c. Arsimi : Të zotërojë diplomë Bachelor në inxhinieri për TIK, Shkencat Kompjuterike, Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit ose barazvlefshme me to si dhe master profesional për sigurinë kibernetike.

d. Kualifikimi: Të zotërojë certifikimin CDFP – Certified Digital Forensic Professional

e. Trajnimi: Të zotërojë [CompTIA Security+](#) certifikatë për TI professional.

f. Eksperienca në Punë: Jo më pak se 3 (tre) vjet eksperiencë në mjediset e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit duke përfshirë njohuri mbi trajtimin e incidenteve, angazhimin në përgjigje ndaj incidenteve/eventeve të sigurisë duke qenë pjesë e strukturave të ndërlidhjes në FA ose në trajtimin e incidenteve/eventeve të sigurisë së shërbimeve në rrjetet kompjuterike.

g. Gjuha e huaj: Anglisht

h. Kërkesa të tjera specifike: Njohuri të strukturave kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë

(ENISA, NIST, ITIL, AKCESK, ISO, OWASP etj.) Njohuri mbi aplikacionet softuare të përdorura nga hackera apo persona keqdashës. Njohuri mbi mjetet që përdoren në kriminalistikën kompjuterike e dixhitale. Njohuri në strukturat e rrjetit LAN/WAN/MAN dhe protokollet e tyre. Njohuri mbi metodologjitë e mbledhjes dhe nxjerrjes së të dhënave. Njohuri mbi metodat dhe procedurat e përdorura në një llojshmëri të gjerë të sistemeve e-mail, arkiva dixhitale dhe backup-e. Njohuri mbi metodat dhe procedurat e përdorura në mbledhjen dhe procesimin e fakteve të kriminalistikës dixhitale të marra nga database arkivore dhe sistemet e backup-it.

- i. **Niveli i certifikatës së sigurisë:** Teper Sekret dhe NATO Secret. Te plotesoje kriteret për tu pajisur me certifikate të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015.

12. Përshkrimi i punës:

Deklarimi i pozicionit: Kryen funksione në përgjigje ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike/kompjuterike në sektorin special të sigurisë kibernetike, siguron veprime të drejtpërdrejta në trajtimin dhe përgjigjen kundrejt incidenteve/eventeve të sigurisë mbi baza të përditshme dhe përgjigjet ndaj eventeve kritike në rrjetet kompjuterike të MM/SHPFA.

Detyrat kryesore:

1. Shqyrton kërkesat për ekzaminime të hollësishme të kriminalistikës dixhitale dhe përcakton llojin e metodologjisë së ekzaminimeve kompjuterike të nevojshme.
2. Kryen ekzaminime kriminalistike dixhitale të kompjuterave dhe mediave dixhitale të lidhura me to.
3. Mbledh të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm me anë të kriminalistikës dixhitale të pajisjeve elektronike dhe kompjuterike duke përdorur një gamë të gjerë mjetesh dhe metodash të miratuara.
4. Përdor mjetet e duhura për të rikuperuar, kthyer nga pajisjet elektronike të lëvizshme që mund të jenë përdorur për marrjen e informacionit të paautorizuar dhe sensitiv.
5. Përgatit raporte të plota dhe të detajuara të rezultatit të ekzaminimit të kriminalistikës dixhitale të kryer.
6. Mbështet agjensitë dhe organet ligjzbatuese me fakte për personat përgjegjës të cilët kanë shkelur ligjin.
7. Ekzaminon dhe analizon të gjitha llojet e pajisjeve media dixhitale të lëvizshme me memorie.
8. Mbledh të gjitha provat dhe faktet e mundshme për përgatitjen e procedurës hetimore për qëllime gjyqësore.
9. Fillon hetimet pas një raporti të aktivitetit që përfshin përdorimin e paligjshëm të kompjuterit sistemet dhe pajisjet e lidhura me ruajtjen e të dhënave elektronike.
10. Inspekton dhe analizon hard disqet e kompjuterit dhe paketat e ndryshme softuerike; deshifron fjalëkalimet dhe identifikon enkriptimet dhe të dhënat.
11. Drejton dhe kryen hetime që përfshijnë përdorimin e programeve të avancuara të kërkimit.
12. Gjeneron korrespondencë hetimore në përputhje me protokollin e departamentit.
13. Kryen studime të cenueshmërisë në sistemet kompjuterike në harduer, softuer dhe sistemet e përdorura për kryerjen e kriminalistikës dixhitale kompjuterike dhe hetimeve të krimit kibernetik.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilin profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.